| **20** | **Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave** | **21** | | | |
| | Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave | 21 | Punonjës arkivi | 6 orë/ditë | Vjetore |
| **22** | **Akademia e Shkencave** | **3** | | | |
| | Akademia e Shkencave | 3 | Nëpunës Informacioni | 6 orë/ditë | Vjetore |
| **26** | **Ministria e Turizmit dhe Mjedisit** | **101** | | | |
| | Aparati i Ministrisë | 2 | Operator EDRMS-je | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 1 | Sanitare | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 2 | Punonjës arkiv/protokolli | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Aparati i Ministrisë | 10 | Specialist | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Mjedisit | 1 | Operator | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Mjedisit | 1 | Nëpunës informacioni | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Mjedisit | 2 | Punonjës arkivi | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Mjedisit | 3 | Specialist | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Mjedisit | 1 | Sanitare | 6 orë/ditë | Vjetore |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Agjencia Kombëtare e Bregdetit | 33 | Specialist | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Bregdetit | 1 | Nëpunës informacioni | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Bregdetit | 1 | Sanitare | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Bregdetit | 4 | Sanitare | 4 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Bregdetit | 6 | Operator | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura | 12 | Sanitare | 4 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura | 1 | Punonjës arkiv/protokolli | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura | 8 | Operator | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura | 1 | Nëpunës informacioni | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura | 1 | Punonjës mirëmbajtjeje | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Pyjeve | 2 | Operator | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Pyjeve | 1 | Sanitare | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Pyjeve | 1 | Nëpunës informacioni | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Turizmit | 1 | Nëpunës informacioni | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Turizmit | 1 | Sanitare | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Turizmit | 1 | Punonjës mirëmbajtjeje | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve | 1 | Nëpunës informacioni | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve | 1 | Sanitare | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve | 1 | Punonjës mirëmbajtjeje | 6 orë/ditë | Vjetore |
| **28** | **Prokuroria e Përgjithshme** | **41** | | | |
| | Prokuroria e Përgjithshme | 14 | Specialist arkivi | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Prokuroria e Përgjithshme | 1 | Lulishtar | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Prokuroritë e Rretheve | 6 | Sanitare | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Prokuroritë e Rretheve | 7 | Teknik mirëmbajtjeje | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Prokuroritë e Apelit Tirane | 1 | Sanitare | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Prokuroritë e Rretheve | 12 | Specialist arkivi | 6 orë/ditë | Vjetore |
| **29** | **Këshilli i Lartë Gjyqësor** | **24** | | | |
| | Aparati dhe Gjykatat | 10 | Operator | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Aparati dhe Gjykatat | 2 | Sanitare | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Aparati dhe Gjykatat | 5 | Punonjës arkivi | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Aparati dhe Gjykatat | 2 | Sekretar gjyqësore | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Aparati dhe Gjykatat | 1 | Specialist | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Aparati dhe Gjykatat | 4 | Punonjës sigurie | 6 orë/ditë | Vjetore |
| **30** | **Gjykata Kushtetuese** | **2** | | | |
| | Gjykata Kushtetuese | 2 | Specialist arkiv/protokolli | 6 orë/ditë | Vjetore |
| **31** | **Agjencia Telegrafike Shqiptare** | **10** | | | |
| | Agjencia Telegrafike Shqiptare | 9 | Specialist | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Telegrafike Shqiptare | 1 | Teknik i mesëm | 6 orë/ditë | Vjetore |
| **35** | **Këshilli i Lartë i Prokurorisë** | **3** | | | |
| | Këshilli i Lartë i Prokurorisë | 2 | Operator | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Këshilli i Lartë i Prokurorisë | 1 | Punonjës pastrimi | 6 orë/ditë | Vjetore |
| **41** | **Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar** | **4** | | | |
| | SPAK/BKH | 2 | Specialist arkivi | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | SPAK/BKH | 1 | Specialist arkiv-protokolli | 8 orë/ditë | 6-muaj |
| | SPAK/BKH | 1 | Sanitare | 8 orë/ditë | 6-muaj |
| **57** | **Qendra Kombëtare e Kinematografisë** | **1** | | | |
| | Qendra Kombëtare e Kinematografisë | 1 | Sanitare | 6 orë/ditë | Vjetore |
| **63** | **Kolegji i Posaçëm i Apelimit** | **4** | | | |
| | Kolegji i Posaçëm i Apelimit | 1 | Korrier/shofer | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Kolegji i Posaçëm i Apelimit | 2 | Specialist | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Kolegji i Posaçëm i Apelimit | 1 | Sekretar gjyqësore | 6 orë/ditë | Vjetore |
| **63** | **Inspektorati i Lartë i Drejtësisë** | **12** | | | |
| | Inspektorati i Lartë i Drejtësisë | 8 | Specialist | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Inspektorati i Lartë i Drejtësisë | 2 | Nëpunës informacioni | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Inspektorati i Lartë i Drejtësisë | 2 | Sanitare | 6 orë/ditë | Vjetore |
| **66** | **Avokati i Popullit** | **3** | | | |
| | Avokati i Popullit | 3 | Specialist | 6 orë/ditë | Vjetore |
| **67** | **Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil** | **5** | | | |
| | Komisioneri | 1 | Punonjës pastrimi | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Komisioneri | 1 | Operator | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Komisioneri | 1 | Nëpunës informacioni | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Komisioneri | 2 | Punonjës arkiv/protokolli | 6 orë/ditë | Vjetore |
| **77** | **Autoriteti i Konkurrencës** | **1** | | | |
| | Autoriteti i Konkurrencës | 1 | Teknik mirëmbajtjeje | 6 orë/ditë | Vjetore |
| **87** | **Institucione të tjera qeveritare** | **49** | | | |
| | Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike | 1 | Sanitare | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike | 1 | Punonjës mirëmbajtjeje | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike | 1 | Punonjës arkivi | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia e Prokurimit Publik | 6 | Punonjës arkivi (DPA) | 6 orë/ditë | Vjetore |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Departamenti Administratës Publike | 1 | Nëpunës informacioni | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Departamenti Administratës Publike | 1 | Punonjës mirëmbajtjeje | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Departamenti Administratës Publike | 3 | Specialist | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje | 4 | Operator | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike | 1 | Sanitare | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike | 3 | Specialist | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike | 1 | Punonjës mirëmbajtjeje | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Rinisë | 1 | Sanitare | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore | 1 | Sanitare | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (Zyrat e Administrimit të Baseneve Ujore) | 4 | Sanitare | 4 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit | 2 | Specialist | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit | 1 | Punonjës arkivi | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit | 1 | Sanitare | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore | 2 | Sanitare | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore | 6 | Specialist | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës | 2 | Sanitare | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës | 4 | Operator | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Komiteti për Pakicat Kombëtare | 1 | Teknik mirëmbajtjeje | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Komiteti për Pakicat Kombëtare | 1 | Sanitare | 6 orë/ditë | Vjetore |
| **88** | **Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile** | **2** | | | |
| | Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile | 1 | Specialist | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile | 1 | Sanitare | 6 orë/ditë | Vjetore |
| **89** | **Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale** | **6** | | | |
| | Komisioneri | 1 | Sanitare | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Komisioneri | 1 | Teknik i mesëm | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Komisioneri | 2 | Specialist | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Komisioneri | 1 | Punonjës arkivi | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Komisioneri | 1 | Nëpunës informacioni | 6 orë/ditë | Vjetore |
| **90** | **Komisioni i Prokurimit Publik** | **4** | | | |
| | Komisioni i Prokurimit Publik | 1 | Punonjës protokolli | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Komisioni i Prokurimit Publik | 3 | Operator | 6 orë/ditë | Vjetore |
| **95** | **Autoriteti Informimit Dok. Ish-Sigurimit të Shtetit** | **14** | | | |
| | Aparati i institucionit | 4 | Punonjës arkivi | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Aparati i institucionit | 4 | Operator | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Aparati i institucionit | 1 | Biblotekar | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Aparati i institucionit | 1 | Teknik i mesëm | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | Aparati i institucionit | 4 | Nëpunës informacioni | 6 orë/ditë | Vjetore |
| | **TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË** | **2,298** | | | |

## VENDIM
## Nr. 20, datë 9.1.2025

## PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË PENSIONISTËVE PËR VITIN 2025

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të aktit normativ nr. 5, datë 19.12.2024, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2023, 'Për buxhetin e vitit 2024', të ndryshuar", me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbështetjen financiare, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, të personave, sipas kategorive të mëposhtme:

a) Personat që përfitojnë pension pleqërie deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe nr. 4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë" dhe nr. 4976, datë 29.6.1972, "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë";

b) Personat që përfitojnë pension invaliditeti, pension familjar dhe pension social, sipas ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe nr. 4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë";

c) Personat që nuk përfitojnë pension, por janë përfitues vetëm të trajtimit financiar, si fëmijë në

përkujdesje të Republikës, sipas ligjit nr. 129/2021, "Për statusin fëmijë në përkujdesje të Republikës";

ç) Personat që nuk përfitojnë pension, por janë përfitues vetëm të trajtimit të veçantë financiar, sipas neneve 5/1/a ose 5/1/b, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

d) Personat që nuk përfitojnë pension, por janë përfitues vetëm sipas ligjit nr. 8455, datë 4.2.1999, "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve që humbasin jetën në përmbushje të detyrës gjatë fluturimit";

dh) Personat që nuk përfitojnë pension, por që trajtohen vetëm me shpërblimin financiar si veteranë të LANÇ-it, sipas vendimit nr. 190, datë 3.5.1995, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin e ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, "Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar", si dhe personat, të cilët marrin vetëm pension të posaçëm për merita të veçanta, sipas dispozitave të ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë";

e) Personat që përfitojnë pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe nuk janë të punësuar në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

ë) Personat që përfitojnë pension deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas ligjit nr. 150/2014, "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë";

f) Personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas ligjit nr. 8685, datë 22.6.2000, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë", të ndryshuar;

g) Personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake", të ndryshuar;

gj) Personat që përfitojnë pension për shkak të profesionit të vështirë, deri në masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, përfshirë edhe këtë masë, sipas nenit 5, të ligjit nr. 29/2019, "Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji".

2. Mbështetjen financiare, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë, të personave, sipas kategorive të mëposhtme:

a) Personat që përfitojnë pension pleqërie me masë pensioni mbi 20 000 (njëzet mijë) lekë, sipas ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe nr. 4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë, ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë";

b) Personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, mbi masën e pensionit 20 000 (njëzet mijë) lekë, sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake", të ndryshuar;

c) Personat që përfitojnë pension me masë pensioni mbi 20 000 (njëzet mijë) lekë, sipas ligjit nr. 150/2014, "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë";

ç) Personat që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 8685, datë 22.6.2000, "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë", të ndryshuar, me masë përfitimi mbi 20 000 (njëzet mijë) lekë;

d) Personat që përfitojnë pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, me masë përfitimi mbi 20 000 (njëzet mijë) lekë, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

dh) Personat që nuk përfitojnë pension, por që përfitojnë vetëm pension shtetëror të posaçëm të caktuar, në përputhje me nenin 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;

e) Personat që nuk përfitojnë pension nga ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, por përfitojnë pension suplementar të caktuar, sipas ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", të ndryshuar;

ë) Personat që përfitojnë pension për shkak të profesionit të vështirë, sipas nenit 5, të ligjit nr. 29/2019, "Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji", me masë përfitimi mbi 20 000 (njëzet mijë) lekë.

3. Të drejtën për të përfituar mbështetje financiare, në masën e përcaktuar sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, e kanë edhe ata persona që u lind e drejta e përfitimit, deri në datën 28.2.2025, duke përfshirë edhe këtë datë, dhe kanë të drejtë ta marrin vetëm një herë këtë mbështetje financiare, pavarësisht se mund të përfitojnë më shumë se një përfitim.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 6 298 145 000 (gjashtë miliardë e dyqind e nëntëdhjetë e tetë milionë e njëqind e dyzet e pesë mijë) lekë, e ndarë në 6 254 365 000 (gjashtë miliardë e dyqind e pesëdhjetë e katër milionë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë për mbështetjen financiare dhe 43 780 000 (dyzet e tre milionë e shtatëqind e tetëdhjetë mijë) lekë shpenzime administrative për dhënien e mbështetjes financiare.

5. Pagesat e mbështetjes financiare kalohen në llogaritë e pensionistëve në muajin mars 2025 dhe paguhen gjatë këtij muaji. Në rastet kur pagesat efektive nuk kryhen brenda muajit mars 2025, ato do të paguhen deri më 30.9.2025. Pagesat e patërhequra parashkruhen pas datës 30.9.2025.

6. Administrimi i fondeve buxhetore të mbështetjes financiare të pensionistëve, caktimi i masës së mbështetjes financiare për çdo përfitues dhe pagesa realizohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a., dhe bankat e nivelit të dytë, sipas të njëjtave procedura, që zbatohen për administrimin e fondit të sigurimeve shoqërore.

7. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi. Efektet financiare të këtij vendimi do të përballohen nga llogaria e mbështetjes për pensionistët në Bankën e Shqipërisë me emërtimin "Fondi i pensioneve".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 mars 2025.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

## VENDIM
## Nr. 22, datë 9.1.2025

## PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 138, DATË 12.3.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR RREGULLAT E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË SHKOLLËS SHQIPTARE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE, TRAJNIMIN E NËPUNËSVE CIVILË, SI DHE TË ÇDO INDIVIDI TJETËR JASHTË SHËRBIMIT CIVIL", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 11, dhe 9, pika 5, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 138, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun III bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 9/2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"9/2. Fondet për trajnimin e nëpunësve, sipas pikës 9/1, të këtij kreu, që janë të punësuar në institucione buxhetore të administratës publike, përballohen nga fondet e buxhetit të shtetit të akorduara në buxhetin vjetor të ASPA-s për këtë qëllim. Për të planifikuar fondet e nevojshme, ASPA

bashkëpunon me institucionet që kanë nevojë për këto trajnime.”.

b) Pas pikës 9/2 shtohet pika 9/3, me këtë përmbajtje:

“9/3. Fondet për trajnimin e nëpunësve, sipas pikës 9/1 të këtij kreu, që janë të punësuar në institucionet/organizatat publike, që funksionojnë me vetëfinancim, shoqëritë aksionare publike dhe institucionet publike të arsimit të lartë përballohen nga fondet e vetë institucionit, ku janë të punësuar nëpunësit. Këto institucione paguajnë pranë ASPA-s 3 000 (tre mijë)–7 000 (shtatë mijë) lekë për kurs trajnimi për çdo nëpunës, në varësi të kohëzgjatjes së kursit.”.

2. Në kreun IV bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas shkronjës “d”, të pikës 1, shtohet shkronja “dh”, me këtë përmbajtje:

“dh) për programe trajnimi që lidhen me sigurinë e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit.”.

b) Në pikën 2, fjalët “Për trajnimet e parashikuara në pikën 1, të kreut IV, të këtij vendimi ...”, zëvendësohen me “Për trajnimet e parashikuara në shkronjat “a” deri në “d”, të pikës 1, të këtij kreu ...”.

3. Në kreun VI bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në shkronjën “b”, të pikës 2, fjalët “... dhe 6–10 vite...” zëvendësohen me “... dhe mbi 5 deri në 10 vjet ...”;

b) Në shkronjën “c”, të pikës 2, fjalët “... dhe mbi 11 vite...” zëvendësohen me “... dhe mbi 10 vjet ...”;

c) Shkronjat “b” dhe “b/1”, të pikës 4, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“b) për kontratat e parashikuara në shkronjën “c”, të pikës 1, të këtij kreu, masa e pagesës për hartimin e kurrikulave apo të materialeve të trajnimit, të nevojshme për zhvillimin e 6 orëve 60-minutëshe trajnimi, të jetë:

i. 24 000 (njëzet e katër mijë) lekë për trajnerët që plotësojnë kriteret e parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 3 të këtij kreu;

ii. 36 000 (tridhjetë e gjashtë mijë) lekë për trajnerët që plotësojnë kriteret e parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 3, të këtij kreu;

b/1) për kontratat e parashikuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij kreu, masa e pagesës për vlerësimin e cilësisë së kurrikulave apo materialeve të trajnimit të nevojshme për zhvillimin e 6 orëve 60-minutëshe trajnimi, të jetë 20 000 (njëzet mijë) lekë;”.

4. Lidhja nr. 1 bashkëlidhur vendimit zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2025.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

MASAT E PAGESAVE PËR TRAJNERËT

| Kategoria e trajnerëve | Masa e pagesës |
|---|---|
| I ulët | 2 000 lekë/orë 60-minutëshe trajnimi |
| I mesëm | 2 500 lekë/orë 60-minutëshe trajnimi |
| I lartë | 3 500 lekë/orë 60-minutëshe trajnimi |
| Trajnerë të kategorisë së veçantë | 4 000 lekë/orë 60-minutëshe trajnimi |

## VENDIM
## Nr. 25, datë 10.1.2025

## PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 325, DATË 31.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGAVE, NIVELEVE TË PAGAVE DHE SHTESAVE TË TJERA MBI PAGË TË ZËVENDËSMINISTRIT, FUNKSIONARËVE TË KABINETEVE, PREFEKTIT, NËNPREFEKTIT, NËPUNËSVE CIVILË DHE NËPUNËSVE NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të shkronjës “h”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe të neneve 7 e 9, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës

së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Në shkronjën "dh", të pikës 1, të kreut I, pas fjalëve "... të kësaj pike ..." shtohen "... dhe Zyra e Administrimit të Parkut Kombëtar "Lumi i Vjosës" ...";

b) Në pikën 11, të kreut III, pas togfjalëshit "... të pikës 1, të kreut I ..." shtohen fjalët "... dhe në Zyrën e Administrimit të Parkut Kombëtar "Lumi i Vjosës" ...";

c) Në pikën 5, të lidhjes nr. 3, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

i. Në shkronjën "ç", pas fjalëve "... dhe "koordinator" ..." shtohen "... në varësi të drejtpërdrejtë të drejtorit të Departamentit ...";

ii. Në shkronjën "d", pas fjalëve "... dhe "specialist" ..." shtohen "... në drejtorinë përgjegjëse për dokumentacionin ...";

iii. Në shkronjën "dh", fjalët "... në departamentet përgjegjëse për aktet ligjore prioritare të Këshillit të Ministrave dhe për politikat, integrimin evropian dhe mirëqeverisjen ..." zëvendësohen me "... në departamentin përgjegjës për politikat, integrimin evropian dhe mirëqeverisjen ...";

iv. Në nënndarjen "i", të shkronjës "e", fjalët "... aktet ligjore prioritare të Këshillit të Ministrave ..." zëvendësohen me "... aktet rregullatore të Këshillit të Ministrave ...";

v. Nënndarja "ii", e shkronjës "e", ndryshohet, si më poshtë vijon:

"ii. "drejtor drejtorie" në departamentin përgjegjës për politikat, integrimin dhe mirëqeverisjen dhe në njësitë përgjegjëse për monitorimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional dhe për programimin e akteve rregullatore dhe RIA, në departamentin përgjegjës për aktet rregullatore të Këshillit të Ministrave;".

vi. Në shkronjën "ë", fjalët "... në departamentin përgjegjës për aktet ligjore prioritare të Këshillit të Ministrave ..." zëvendësohen me "... në njësitë përgjegjëse për monitorimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional dhe për programimin e akteve rregullatore dhe RIA, në departamentin përgjegjës për aktet rregullatore të Këshillit të Ministrave ...".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion dhe fillojnë:

a) nga momenti i emërimit të nëpunësve /punonjësve për përcaktimet në shkronjat "a" dhe "b", të pikës 1, të këtij vendimi;

b) nga momenti i transferimit në pozicionet e reja të nëpunësve në ish-departamentin përgjegjës për aktet ligjore prioritare të Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

## VENDIM
## Nr. 26, datë 10.1.2025

## PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË PËRFITIMIT, KRITEREVE DHE KUSHTEVE TË VEÇANTA TË PËRFITIMIT PËR NDËRMARRJET MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME, PËR VITIN 2025

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të pikës 6, të nenit 11, të ligjit nr. 43, datë 21.4.2022, "Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme", me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e masës së përfitimit, kriteret dhe kushtet e veçanta të përfitimit me fond për mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (në vijim NMVM), të cilat synojnë rritjen e konkurrueshmërisë së tyre, zhvillimin e produkteve dhe të shërbimeve, zhvillimin e biznesit kreativ, mbështetjen e grave sipërmarrëse, inovacionin e rinovimin e teknologjisë, me qëllim nxitjen drejt eksportit dhe forcimin e aftësive të NMVM-ve për shërbimet e produktet për një treg të qëndrueshëm.

2. Termat e përdorur në përmbajtje të këtij projektvendimi kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet e dhëna në pikat 4 e 5, të nenit 3, të ligjit nr. 43/2022, "Për zhvillimin e ndërmarrjeve

mikro, të vogla dhe të mesme".

3. Nuk përfitojnë nga ky fond ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, të cilat kanë përfituar burime financimi nga donatorë apo institucione financiare kombëtare dhe ndërkombëtare për të njëjtët zëra apo aktivitete të lejuara nga këto projekte.

II. MASA E PËRFITIMIT, KRITERET DHE KUSHTET E VEÇANTA PËR PËRFITIMIN E FONDIT

1. Skema e mbështetjes financiare për shpenzimet korrente të programit ekonomik (04130) "Mbështetje për zhvillimin ekonomik" të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit është në vlerën 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, që mbulon 100% të kostove të miratuara, por jo më shumë se 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë.

2. Skema e mbështetjes financiare për zërin "Shpenzimet kapitale", që përdoret për mbështetjen e projekteve të investimeve, është në vlerën 31 830 000 (tridhjetë e një milionë e tetëqind e tridhjetë mijë) lekë, nga të cilat për:

a) projekte për konkurrueshmërinë, në vlerën 21 830 000 (njëzet e një milionë e tetëqind e tridhjetë mijë) lekë, mbulon 100% të kostove të miratuara, por jo më shumë se 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë;

b) projekte në mbështetje të artizanatit, në vlerën 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, mbulon 100% të kostove të miratuara, por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë.

3. Aplikuesit për përfitimin e fondit plotësojnë kriteret e përgjithshme, të përcaktuara në pikën 5, të ligjit nr. 43/2022, "Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme", si dhe kriteret e veçanta të lidhura me projektplanin e biznesit, si më poshtë vijon:

a) Përputhshmëria e planit të biznesit me objektin dhe qëllimet e dhënies së fondit, duke pasur në fokus nxitjen drejt eksportit dhe forcimin e aftësive të NMVM-ve për shërbimet e produktet për një treg të qëndrueshëm;

b) Qartësia, saktësia dhe objektiviteti i planit të biznesit, elemente, të cilat identifikohen nëpërmjet rezultateve të matshme nga realizimi i tij;

c) Qartësia e përshkrimit të aktiviteteve që do të realizohen;

ç) Qartësia e përshkrimit të impaktit dhe e rezultateve të matshme;

d) Të dhëna konkrete, që aktivitetet e ndërmarrjes rrisin numrin e të punësuarve;

dh) Të dhëna konkrete dhe të argumentuara për impaktin pozitiv mjedisor.

4. Aktivitetet e lejuara, me qëllim përfitimin e fondit, janë, si më poshtë vijon:

a) Skema e mbështetjes financiare për zërin "Shpenzimet korrente" mbulon kostot e mëposhtme:

i. certifikimin e standardeve të prodhimit/shërbimit (përfshirë konsulencën përkatëse në fazën përgatitore);

ii. përmirësimin e produktit përmes etiketimit e ambalazhimit;

iii. trajnime të stafit të ndërmarrjes për rritje kapacitetesh në fusha të tilla, si: menaxhimi i teknologjive digjitale/inovatore, rrjetet e prokurimit, shërbime marketingu, zhvillimi dhe modernizimi i infrastrukturës së biznesit, sisteme të reja logjistike *software*-ike apo pajisje të reja etj. dhe pajisje me certifikatat përkatëse nga subjekte të licencuara për trajnime;

iv. pjesëmarrje në panaire ndërkombëtare me stenda të gatshme;

v. krijimin e aplikacioneve apo të platformave, në funksion të zhvillimit të proceseve lidhur me tregtinë elektronike/"*e-commerce*", produkteve të reja dhe/ose shërbimeve, për të përmbushur kërkesat e industrisë së tregut në vend e rajon, për të përmirësuar biznesin, sistemet logjistike etj.;

vi. përgatitjen e materialeve promovuese, si: banera, fletëpalosje, katalogë, broshura për përmirësim të imazhit të NMVM-ve (jo më shumë se 20% e kostos totale të projektit);

b) Skema e mbështetjes financiare për zërin "Shpenzimet kapitale" mbulon kostot e mëposhtme:

i. projektin për konkurrueshmërinë për blerjen e makinerive, që ndikojnë në rritjen e prodhimit e të përmirësimit të cilësisë së produktit;

ii. projektin për mbështetjen e artizanatit për:

- blerjen e makinerive tradicionale dhe/ose teknologjike për të përmirësuar kushtet e punës për biznesin;
- blerjen e aplikacioneve dhe/ose të programeve "*e-commerce*".

5. Dokumentacioni i nevojshëm, që duhet të shoqërojë kërkesën për aplikim, është, si më poshtë vijon:

a) Formulari i kërkesës së plotësuar;

b) Formulari i buxhetit;
c) Certifikata e regjistrimit në regjistrin tregtar;
ç) Ekstrakti historik i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), me status aktiv;
d) Deklarata për kategorinë e NMVM-ve, në përputhje me parashikimin e dhënë në nenin 5, të ligjit nr. 43/2022;
dh) Vërtetimi, që subjekti ka paguar të gjitha detyrimet tatimore në momentin e dorëzimit të kërkesës për përfitim fondi, të shkarkuar nga platforma qeveritare "*e-Albania*";
e) Vërtetimi, që subjekti ka paguar të gjitha detyrimet shëndetësore dhe shoqërore në momentin e dorëzimit të kërkesës për përfitim fondi, të shkarkuar nga platforma qeveritare "*e-Albania*";
ë) Vërtetimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, që ka paguar detyrimet doganore, në rastin kur NMVM-ja është eksportuese në momentin e dorëzimit të kërkesës për përfitim fondi, të shkarkuar nga platforma qeveritare "*e-Albania*";
f) Pasqyrat financiare të vitit të fundit të ushtrimit të aktivitetit, të certifikuara nga organet tatimore dhe/ose formulari i deklarimit të të ardhurave, i shkarkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
g) Dëshmia e penalitetit të administratorit të ndërmarrjes, e shkarkuar nga platforma qeveritare "*e-Albania*";
gj) Kopja e ID-së së administratorit të NMVM-së ose prokura e përfaqësimit dhe ID-ja e përfaqësuesit, në rast se aplikuesi nuk është administratori i NMVM-së.

Dokumentet e aplikimit duhet të dorëzohen të firmosura dhe të vulosura nga aplikuesi, origjinal ose kopje, të njësuar me origjinalin, dhe të kenë afat vlefshmërie jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e aplikimit për fonde.

6. Disbursimi i fondit do të bëhet me 2 (dy) këste, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 539, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, funksionimin, shpërblimin e anëtarëve të bordit vlerësues të kërkesave, si dhe procedurën konkurruese për dhënien e granteve për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme", të ndryshuar.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2025/01/13 17:05:22 +02'00'
f3e877eddea44504a8e97022a7d5bed7202501131 7051445031

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)*